



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Njoftim për konsultim me publikun

*“Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore
Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri”.*

Bashkia e Shkodrës fton për informim dhe konsultim publik këshilltarët, qytetarët, teknicienët dhe palët e interesuara në diskutimin mbi “Projektin e Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri”, pjesë e korridorit të X-të, mbështetur nga Fondet e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër Hekurudha Shqiptare Sh.a., në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, me qëllim informimin dhe përfshirjen e aktorëve vendorë, në mënyrë që të arrihen zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët e prekura, ka filluar procesin e takimeve konsultuese me publikun.

Palët e interesuara dhe që mund të ndikohen/preken nga aktivitetet e parashikuara për punimet rehabilituese të linjës hekurudhore janë të ftuara të marrin pjesë në këtë takim, për të pasur një gjithpërfshirje sa më të madhe të shoqërisë, bizneseve e komunitetit me vendbanim pranë linjës hekurudhore.

***Takim do të zhvillohet më datë 18 / 06 / 2021 ora 12:30 , Pranë Bashkisë Shkodër, Salla e
Këshillit Bashkiak.***

Jeni të lutur të konsultoni paraprakisht Përmbledhjen Jo-teknike (Dokumentet bashkëlidhur)

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

